

**VENDIM**  
**Nr. 819, datë 30.12.2025**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 428, DATË 26.6.2024, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE DHE TË MËNYRËS SË PËRDORIMIT**  
**TË TYRE PËR SHËRBIMET QË KRYHEN NGA SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT**  
**KOMBËTAR TË TERRITORIT DHE UJIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 46/1, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në kreun I, të vendimit nr. 428, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas shkronjës “f”, të pikës 3, shtohet shkronja “g”, me këtë përmbajtje:

“g) certifikata për përfundimin e punimeve të karabinasë.”.

2. Në pikën 4 bëhen këto shtesa:

a) Në fillim të shkronjës “a” shtohen fjalët “... për kërkesat për leje zhvillimi, ...”;

b) Në fillim të shkronjës “b” shtohen fjalët “... për kërkesat për leje zhvillimi, ...”;

c) Pas shkronjës “b”, të pikës 4, shtohen shkronjat “c” dhe “ç”, me këtë përmbajtje:

“c) për kërkesat për ndryshimin/rishikimin e lejeve të zhvillimit, kur ndryshimi apo rishikimi i lejes së zhvillimit kryhet brenda kufirit të miratuar me një leje zhvillimi dhe nuk shoqërohet me shtim të sipërfaqes së përgjithshme të pronës apo kur kërkesa për ndryshimin/rishikimin e lejeve të zhvillimit shoqërohet me zvogëlim të sipërfaqes së miratuar me një leje zhvillimi, tarifa është fikse, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë;

ç) për kërkesat për ndryshimin/rishikimin e lejeve të zhvillimit, kur ndryshimi apo rishikimi i lejes së zhvillimit shoqërohet me shtim të sipërfaqes së përgjithshme të pronës, tarifa llogaritet si total i tarifës fikse, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë, dhe shtohet vlera prej 100 (njëqind) lekë për m<sup>2</sup>, vetëm për sipërfaqen shtesë.”.

3. Pas fjalisë së parë të pikës 8/1 shtohen fjalitë, me këtë përmbajtje:

“Në rast se ndërmjet situacionit përfundimtar të punimeve dhe preventivit fillestar të investimit të deklaruar nuk ka diferencë apo vlera e situacionit përfundimtar është më e vogël sesa vlera e preventivit fillestar ose në rastet e certifikatave të veçanta, sipas përcaktimeve të pikës 8, të nenit 42, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, tarifa është fikse, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë. Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për lëshimin e certifikatave për përfundimin e punimeve të karabinasë është fikse, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë.”.

**II. Dispozitë kalimtare**

Agjencia e Zhvillimit të Territorit merr të gjitha masat për lëshimin e faturave, sipas tarifave të përcaktuara në këtë vendim, për të gjitha vendimmarrjet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, që nënshkruhen pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

III. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**